



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VIII**

*Sesioni vjeshtor*

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Mbledhja nr. 57**

**Prishtinë, më 8.10.2024, në orën 11:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204**

**PROCESVERBAL**

**Morën pjesë:** Hydajet Hyseni- Kaloshi dhe Bahrim Shabani, zëvendëskryetarë, Arijeta Rexhepi, Enis Kervan, Valentina Bunjaku- Rexhepi, Shemsedin Dreshaj, Fridon Lala dhe Bekim Arifi, anëtarë.

**Munguan:** Elmi Reçica, Adem Hoxha dhe Fadil Gashi, anëtarë.

**Të pranishëm të tjerë:** Hysni Mehani, asistent i GP LVV; Orgest Topojani, asistent i GP PDK; Jeta Huraglica, asistente e GP LDK; Leonora Gashi, asistente e GP AAK; Ema Krasniqi, përfaqësuese e KDI-së; Zijush Ahmeti, zyrtar i SKKK dhe Celal Iliaz, përfaqësues i Drejtorisë për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Natasa Prica- Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

**Mbledhjen e kryesoi:** Hydajet Hyseni- Kaloshi, zëvendëskryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura me dt 11.07.2024 dhe 26.09.2024;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat, me raport amandamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;
4. Shqyrtimi i Projektligjin nr.08/L-283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta me Ligjin nr. 05/L- 087 për kundërvajtje, me raport amandamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues, me raport amandamente të Komisionit funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti;
6. Të ndryshme.

#### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

#### **2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 11.07.2024 dhe 26.09.2024**

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtur më 11.07.2024 dhe 26.09.2024, u miratuan pa vërejtje.

#### **3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat, me raport- amandamente të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit**

**Zëvendëskryetari** paraqiti për shqyrtim Projektligjit nr. 08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat, me raport-amandamente të Komisionit funksional, dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim.

Shemsedin Dreshaj dhe Valentina Bunjaku Rexhepi, u deklaruan se do të abstenojë për votimin e të njëjtave pika, sipas rendit të ditës.

Duke qenë se nuk pati propozime dhe sugjerime të reja nga anëtarët e Komisionit, dhe në bazë të rezultateve të votimit: për 6, kundër 0, abstenim 2, Komisioni nxori këtë:

#### **Rekomandim**

Projektligji nr. 08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat, me amendamente të Komisionit funksional, nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet për miratim në seancë plenare.

#### **4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta me Ligjin nr. 05/L- 087 për kundërvajtje, me raport-amandamente të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.**

**Zëvendëskryetari** paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.08/L-283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta me Ligjin nr. 05/L- 087 për kundërvajtje, me raport-amandamente të Komisionit funksional, dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim.

Meqë nuk pati diskutime, zëvendëskryetari konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit: për 6, kundër 0, abstenim 2, Komisioni nxori këtë:

### **Rekomandim**

Projektligji nr.08/L-283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta me Ligjin nr. 05/L- 087 për kundërvajtje, me amendamente të Komisionit funksional, nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet për miratim në seancë plenare.

#### **5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues, me raport amendamente të Komisionit funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti;**

**Zëvendëskryetari** paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues, me raport-amendamente të Komisionit funksional, dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim.

Meqë nuk pati diskutime, zëvendëskryetari konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit: për 6, kundër 0, abstenim 2, Komisioni nxori këtë:

### **Rekomandim**

Projektligji nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues, me amendamente të Komisionit funksional, nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet për miratim në seancë plenare.

#### **6. Të ndryshme**

**Enis Kervan**, sa i përket zbatimit të planit të punës për vitin 2024, ai propozoi që Komisioni të vizitojë zyrtarisht Komunën e Lipjanit dhe Komunën e Podujevës, me qëllim që të njihemi me gjendjen e përgjithshme të komuniteteve, nga aspekti i punësimit, arsimimit si dhe shkalla e zbatimit të Ligjit për përdorimin e Gjuhëve.

**Zëvendëskryetari**, në pajtim me planin e punës dhe propozimin e dhen, konstatoi se Komisioni do të realizojë vizitën në Komunën e Lipjanit me dt. 15.10.2024, si dhe në Komunën e Podujevës me dt. 21.10.2024.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

**Hydajet Hyseni- Kaloshi,**

---

**Zëvendëskryetar i Komisionit**